



RAPORT PËRMBYLLËS I ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE KURUM HYDRO-01/BRADASHESH, SHQIPËRI Korrik 2018

Ky raport është një përmbledhje e procesit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të CAO-s dhe rezultatet në lidhje me ankesën Kurum Hydro-01/Bradashesh

HYRJE

Projekti i IFC-së

IFC-ja aktualisht ka një projekt me Kurum International (Kurum), një kompani e prodhimit të çelikut në Shqipëri. Grupi Kurum, i kontrolluar nga familja turke Kurum, operon në industrinë e hekurit dhe çelikut me vizionin për ta zgjeruar aktivitetin e tij dhe në biznese të tjera që lidhen me këtë industri në Turqi dhe në Ballkan. Kurumi ka fituar tenderin për 4 hidrocentrale – Ulëz, Shkopet, Bistrica I dhe Bistrica II, që ishin privatizuar nga qeveria shqiptare në vitin 2012.

Projekti i IFC-së ka për qëllim të financojë blerjen e hidrocentraleve dhe një investimin prej rreth 10 milion Euro për rehabilitimin e tyre. Grupi synon të shfrytëzojë këto hidrocentrale për të siguruar energji të rinovueshme të pandërprerë për uzinën ekzistuese të çelikut. Përmes këtij projekti, Kurum parashikon reduktimin e kostove për blerjen e energjisë elektrike, dhe sigurimin e burimit të vazhdueshëm të energjisë për të vazhduar aktivitetin pa ndërprerje të mëdha. Projekti është klasifikuar nga IFC-ja në Kategorinë Mjedisore B, me rreziqe dhe/ose ndikim mjedisor potencial të limituar.

Ankesa

Në qershor 2015, në Zyrën e CAO-s u dërgua një ankesë nga disa banorë të cilët jetojnë në afërsi të Uzinës së Çelikut Kurum në Elbasan, Shqipëri. Ankuesit ngritën shqetësime në lidhje me ndotjen e ajrit dhe të tokës të shkaktuar nga aktiviteti i uzinës, dhe ndikimin që mund të ketë kjo ndotje në shëndetin e banorëve. Ankesa e redaktuar, e cila mund të gjendet në formë të redaktuar në faqen e internetit të

CAO-s, përmban një përshkrim të detajuar të këtyre çështjeve¹.

Vlerësimi i CAO-s

Duke u bazuar në faktin se energjia e prodhuar nga hidrocentralet do të përdorej potencialisht për uzinën e çelikut, në korrik 2015 CAO doli në përfundimin se ankesa i plotësonte kriteret e pranueshmërisë për vlerësim të mëtejshëm dhe në shtator 2015 ndërmori një mision vlerësues në Shqipëri.

Gjatë vlerësimit, Kurum-i dhe ankuesit vendosën të merrnin pjesë në një proces të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të lehtësuara nga CAO për të eksploruar zgjidhje të pranueshme për të dyja palët për çështjet e ngritura në ankesë. Procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nuk përfshin një verifikim të çështjeve të ngritura në ankesë. Fokusi kryesor është që t'u jepet palëve një mundësi për të zgjidhur çështjet me marrëveshje. Procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve filloi zyrtarisht në tetor 2015.

PROCESI I ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE

Strukturimi i procesit dhe rritja e kapaciteteve

Si hap të parë, CAO i përfshiu palët në një diskutim për strukturën e procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Në diskutim u përfshi dhe arritja e një marrëveshjeje në lidhje me çështjet që do të diskutoheshin, strukturën e takimeve dhe rregullat bazë të komunikimit.

CAO organizoi takime paraprake bilaterale me palët për të kuptuar më mirë këndvështrimet e tyre në lidhje me shqetësimet e ngritura në

¹ http://www.cao-ombudsman.org/cases/document-links/documents/KurumComplaint-Albanian_Redacted.pdf

ankesë, dhe për të vendosur se si do donin ata t'i trajtonin këto shqetësime përmes procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Si rezultat i këtyre takimeve fillestare, CAO kuptoi se midis palëve nuk kishte pasur komunikim dhe marrëdhënie të mëparshme.

Përfaqësues të palëve morën pjesë në workshop-e të veçanta, të drejtuar nga CAO, për të kuptuar procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, për të diskutuar dhe hartuar strukturën e procesit, për të qartësuar çështje si p.sh., si do të përfaqësohen palët, konfidencialiteti dhe rregullat e komunikimit. Workshop-et u fokusuan gjithashtu dhe në rritjen e aftësive komunikuese dhe negociuese, si dëgjimi aktiv, vendimmarrja bazuar në interesa.



Workshop për rritjen e kapaciteteve më anëtarët e komunitetit, 13 Nëntor 2015.



Workshop për rritjen e kapaciteteve më përfaqësues të Kurum-it, 16 Dhjetor 2015.

Si rezultat i workshop-eve për rritjen e kapaciteteve, përfaqësuesit e palëve zhvilluan njohuritë dhe aftësitë e tyre që do t'i ndihmonin për t'u përfshirë në mënyrë konstruktive dhe efektive në procesin e dialogut dhe për të

marrë vendime, si në lidhje me procesin dhe me përfundimet e tij.

Fillimi i dialogut

Në workshopet për rritjen e kapaciteteve u diskutua dhe një Marrëveshje Kuadër për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve (rregullat bazë), të cilat u përgatitën nga CAO, bazuar në preferencat e shprehura nga palët gjatë takimeve paraprake. Sugjerimet, komentet mbi Marrëveshjen u pasqyruan në një dokument përfundimtar, për të cilin u ra dakord dhe u firmos në takimin e parë të përbashkët të palëve në dhjetor 2015. Përfaqësuesit e palëve ranë dakord që Rregullat Bazë të botohen në faqen e internetit të CAO-s².



Rregullat Bazë të Procesit të Dialogut, 17 Dhjetor 2015

Në takimin e parë të përbashkët, palët ndanë me njëra-tjetrën këndvështrimin e tyre në lidhje me shqetësimet e ngritura në ankesë. Në mënyrë më specifike, anëtarët e komunitetit ndanë shqetësimin e tyre në lidhje me ndikimin e pretenduar mjedisor dhe social të uzinës së çelikut të Kurum-it, duke përfshirë çështjet e cilësisë së ajrit, zhurmës dhe mungesën e investimeve dhe punësimit. Përfaqësuesit e Kurum-it prezantuan këndvështrimin e tyre për çështjet e ngritura dhe shpjeguan procedurat e

² Rregullat bazë janë në faqen e internetit të CAO-s në adresën: http://www.cao-ombudsman.org/cases/case_detail.aspx?id=237 (parë më 8 Maj 2018)

operacioneve të tyre, diskutuan masat e ndërmarra për të përmirësuar situatën dhe shpjeguan standardet sipas të cilave operon kompania.



Takimi i parë i përbashkët, drejtuar nga CAO, midis përfaqësuesve të Kurum-it dhe komunitetit, 17 Dhjetor 2015.

Takimi i parë i përbashkët rezultoi në arritjen e një marrëveshjeje midis palëve në lidhje me hapat dhe strukturën e procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, të përmbledhura si më poshtë.



Marrëveshja për Axhendën e Dialogut

Në shkurt 2016 palët ranë dakord për t'i kategorizuar si më poshtë çështjet që do të diskutoheshin:

- Çështjet e cilësisë së ajrit
 - Pakënaqësi në lidhje me cilësinë e ajrit, ndotjen e tokës dhe të ujit
 - Shqetësime në lidhje me shëndetin e banorëve
 - Dëmtimet në bimësi dhe prodhimet bujqësore
- Çështjet e zhurmës
 - Pakënaqësi në lidhje me ndotjen akustike
 - Shqetësime në lidhje me shëndetin e banorëve
- Çështjet sociale në lidhje me perceptimin për mungesë investimesh për komunitetin nga Kurum.

Pezullimi i procesit

Në shkurt 2016, palët ranë dakord për pezullimin e procesit duke marrë parasysh situatën financiare të Kurum-it dhe ndërprerjen e operacioneve. Ata ranë dakord për ta rifilluar procesin kur Kurum-i të ri-niste punën plotësisht, por jo më vonë se qershor 2016. Megjithatë, në shkurt 2017, Kurum paraqiti në Shqipëri dhe Turqi kërkesën për faliment me riorganizim dhe procesi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, me kërkesë të Kurum-it, dhe dakortësi nga përfaqësuesit e komunitetit, mbeti i pezulluar deri në korrik 2017.

Rifillimi i procesit të dialogut dhe vizita e përbashkët në terren

Në korrik 2017, palët shprehën angazhimin për të vazhduar procesin e dialogut. Kurum u shpreh se nuk kishte mundësi të ndërmerre angazhime financiare pa miratim paraprak nga administratori i caktuar nga gjykata. Palët ranë dakord për të bërë një vizitë të një grupi të anëtarëve të komunitetit për t'i ndihmuar ata të kuptonin më mirë operacionet e uzinës dhe për të parë masat e ndërmarra nga kompania për të adresuar impaktin mjedisor të projektit. Vizita në terren u organizua në shtator 2017. Sipas anëtarëve të komunitetit, vizita në terren i ndihmoi të kuptonin më mirë operacionet e kompanisë dhe impaktin mjedisor.



Vizitë e anëtarëve të komunitetit në uzinën e çelikut Kurum, 30 Shtator 2017.

Në takimin e përbashkët në shtator 2017, përfaqësuesit e komunitetit, theksuan se ishin bërë përmirësime që prej vizitës së tyre të mëparshme në uzinë. Në veçanti, ata perceptuan një përmirësim të efektivitetit të filtrave të pluhurit. Në të njëjtën kohë, anëtarët e komunitetit shprehën mendimin se ka hapësirë për përmirësime të mëtejshme, pasi ata mendojnë se ndotja vërehet ende në mëngjes, dhe se nuk ishin të sigurt se nga vinte kjo. Kurum-i e vlerësoi mundësinë për t'u treguar anëtarëve të komunitetit operacionet e tyre, dhe i informuan këta të fundit se mund ta vizitonin uzinën në çdo kohë.



Takim i përbashkët i CAO, Kurum-it dhe anëtarëve të komunitetit, 2017.

CAO publikoi një raport progresi në nëntor 2017, ku përfshihej një përmbledhje e procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve deri në atë moment, dhe përmbante projektet e zbatuara deri atëherë nga kompania për të pakësuar impaktin mjedisor të uzinës. Projektet përfshinin riparimin e çatisë së uzinës së çelikut dhe ndërtimin së fundmi të një

hekurudhe të brendshme për të transportuar skrapin drejtpërdrejt te uzina e çelikut për të shmangur përdorimin e kamionëve dhe për të reduktuar zhurmat. Këto projekte u diskutuan gjatë procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, duke marrë parasysh shqetësimet e ngritura nga anëtarët e komunitetit në lidhje me cilësinë e ajrit.

Monitorimi mjedisor me pjesëmarrje

Si rezultat i dialogut vazhdues, palët ranë dakord të përfshijnë anëtarët e komunitetit në aktivitetet monitoruese mujore të kryera nga LENI-ING sh.p.k, një agjenci monitoruese për mjedisin, e akredituar nga qeveria shqiptare monitorimin mjedisor. Agjencia ka kryer monitorimin mujor të çlirimit të gazrave për Kurum-in që prej muajit janar 2012, dhe monitorimi me pjesëmarrje (dhe të anëtarëve të komunitetit) ishte një mundësi për komunitetin ta vëzhgonin dhe ta kuptonin më mirë këtë proces vazhdues. Në monitorimin me pjesëmarrje, i cili u krye në dhjetor 2017, morën pjesë tre anëtarë të komunitetit, një specialist mjedisor i ftuar nga anëtarët e komunitetit, Drejtori Teknik i Kurum-it dhe CAO.

Përfaqësuesit e LENI-ING sh.p.k u shpjeguan anëtarëve të komunitetit se monitorimi mujor që ata kryejnë përfshin matjen e nivelit të dioksidit të squfurit (SO₂), dioksidit të karbonit (CO₂), dioksidit të azotit (NO₂), dhe oksidit të azotit (NO_x) brenda territorit ku operon kompania. Bazuar në të dhënat e këtij monitorimi, ata përgatisin raporte tremujore që i paraqiten Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë Rajonale të Mjedisit Elbasan dhe Kurum-it.

Gjatë aktivitetit monitorues, Drejtori Teknik i Kurum-it shpjegoi teknologjinë e përdorur për të përmirësuar performancën mjedisore të uzinës, dhe theksoi angazhimin e kompanisë për të investuar për këtë. Ai shpjegoi se që prej vitit 2011, kompania ka bërë investime për të përmirësuar teknologjinë, të cilat, sipas tyre, kanë rezultuar në përmirësime mjedisore, veçanërisht të cilësisë së ajrit. Këto përmirësime përfshijnë përdorimin e gazit natyror si burim djegieje, kapjen e gazit dhe magazinimin, lagjen e rrugëve dhe ndërtimin e

një hekurudhe për të transportuar metalet e skrapit.

Gjatë aktivitetit të monitorimit me pjesëmarrje, fillimisht u organizua një takim në zyrat e Kurum-it me përfaqësuesit e kompanisë, anëtarët e komunitetit, specialistët e LENI-ING sh.p.k dhe CAO-s. Takimi u pasua nga një vizitë në terren për të vëzhguar aktivitetin monitorues të kryer LENI-ING, duke përfshirë marrjen e kampionëve dhe pajisjet e përdorura për të mbledhur të dhënat në uzinën e skrapit, te uzina e shkrirjes, furra e çelikut, dhe te vendndodhja e magazinimit të gazit. Gjatë monitorimit me pjesëmarrje, anëtarët e komunitetit bënë pyetje në lidhje me procesin e përzgjedhjes së kompanisë monitoruese të mjedisit, pavarësinë e saj, dhe koordinimin e saj me procesin monitorues të kryer nga agjencia rajonale e mjedisit. Ata ishin të interesuar të dinin nëse matjet bëhen dhe pranë shtëpive pranë Kurum-it (dhe jo vetëm brenda perimetrit të operimit të kompanisë), si dhe nëse LENI-ING kishte vërejtur përmirësime mjedisore që prej fillimit të monitorimit nga ana e saj të operacioneve të Kurum-it. Anëtarët e komunitetit gjithashtu shprehën interes të dinin nëse bëhen monitorime të ujit dhe të tokës, përveç monitorimit të çlirimit të gazeve në atmosferë.

Mbyllja e Procesit të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve

Pas monitorimit me pjesëmarrje, CAO pati takime të veçanta me palët për të qartësuar preferencat dhe opsionet e tyre në lidhje me hapat e mëtejshëm. Ndërkohë që anëtarët e komunitetit i vlerësojnë përpjekjet e Kurum-it për të përmirësuar situatën, ata vazhdojnë të kenë rezerva pas vizitës monitoruese, si për sa i përket impaktit të uzinës siç pretendojnë ata, ashtu dhe për gjetjet e monitorimit të kryer nga LENI-ING. Anëtarët e komunitetit treguan interes për të bashkëpunuar me kompaninë për të ndërmarrë një proces monitorues të përbashkët dhe për të identifikuar një agjenci ose ekspert ndërkombëtar duke u ngarkuar detyrën të shqyrtojnë dhe t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me impaktet e pretenduara mjedisore të kompanisë. Anëtarët e komunitetit shprehën interes për një proces të përbashkët hulumtimi, për të rritur transparencën në

strukturimin dhe zbatimin e procesit monitorues, si dhe për të rritur në këtë mënyrë besimin në rezultatet e këtij procesi.

“Thjesht duam të dimë nëse është e sigurt të jetojmë dhe të rrisim fëmijët tanë këtu.”

Këndvështrim i shprehur nga një anëtar i komunitetit gjatë takimeve bilaterale me grupin e ndërmjetësve të CAO-s

CAO informoi Kurum-in për këtë pozicion të komunitetit. Kompani theksoi se procesi aktual monitorues kryhet nga një agjenci mjedisore monitoruese e akredituar, të cilët prodhojnë raporte tremujore që u dorëzohen institucioneve shqiptare përkatëse. Duke ditur këtë, ata nuk ishin në favor të një procesi tjetër monitorues.

“Kompania është e angazhuar të vazhdojë përmirësimin e mjedisit.”

Këndvështrim i shprehur nga një përfaqësues i kompanisë gjatë takimit të fundit të përbashkët

Takimi i fundit i përbashkët u mbajt në shkurt 2018, gjatë së cilit palët ranë dakord si më poshtë:

- Kurum mori përsipër të njoftonte CAO-n brenda 10-ditëve pas takimit në lidhje me mundësinë për ndërmarrjen e një procesi të përbashkët hulumtues për të parë ndikimet mjedisore të kompanisë brenda një zone më të gjerë industriale në jetën e banorëve në afërsi të uzinës;
- Në varësi të përgjigjes nga kompania, CAO ose do të vazhdonte procesin e dialogut (me vullnetin e shprehur dhe me kërkesë nga palët) dhe do të zbatonte një proces të hulumtues të përbashkët, ose do ta mbyllte procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe ta transferonte çështjen në zyrën e auditit të CAO-s në përputhje me Udhëzimet Operacionale të CAO-s.

Pavarësisht diskutimeve të zhvilluara gjatë takimit të fundit të përbashkët, nga kompania

Kurum nuk u kthye përgjigje në lidhje me mundësinë e procesit të përbashkët hulumtues. CAO iu adresua Kurum-it duke i kërkuar një përgjigje në lidhje me pozicionin e tyre brenda datës 23 Mars 2018, dhe e njoftoi kompaninë se, në mungesën e një përgjigjeje, CAO do të nënkuptonte se kompania nuk ishte dakord për të ndërmarrë një proces të përbashkët hulumtues dhe se ankesa do të transferohej nga mekanizmi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve te mekanizimi i auditit.

CAO nuk mori përgjigje nga Kurum brenda afatit të caktuar dhe nuk ka pasur njoftime të mëtejshme nga Kurum-i në lidhje me pozicionin e tyre që prej muajit shkurt 2018. Në këto rrethana, CAO e mbylli procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, dhe e transferoi çështjen në procesin e vlerësimit për t'u kaluar në audit, ku fokusi është roli i IFC-së në lidhje me projektin.

Rezultate të Procesit

Si rezultat i marrëveshjeve të arritura ndërmjet palëve gjatë procesit të dialogut, dhe punën e ndërmarrë më pas nga Kurum, u arritën rezultatet e mëposhtme:

- **Marrëveshje mbi Rregullat Bazë:** Megjithëse palët nuk mundën përfundimisht të arrinin një marrëveshje për çështjet thelbësore, në fillim të procesit arritën një marrëveshje në lidhje me rregullat bazë procedurale që do të drejtonin procesin e dialogut.
- **Mirëkuptimi reciprok:** Pjesëmarrësit e përfshirë në procesin e dialogut arritën të kishin mirëkuptim reciprok për çështjet. Përfaqësuesit e Kurum-it arritën të kuptonin më mirë se kush ishin ankuesit, si dhe shqetësimet dhe qëllimet e tyre respektive. Anëtarët e komunitetit mësuan më shumë rreth iniciativave të ndërmarrura nga Kurum për të adresuar impaktet mjedisore të uzinës së çelikut. Për më tepër, në procesin e dialogut u arrit marrëveshje që anëtarët e komunitetit të vizitonin uzinën për të kuptuar më mirë procesin e punës dhe impaktet mjedisore.
- **Rritja e kapaciteteve:** CAO i asistoi palët duke i përgatitur për një pjesëmarrje aktive

në procesin e dialogut, duke rritur aftësitë e tyre në komunikim dhe negociim.

- **Riparimi i çatisë:** Procesi i riparimit të çatisë u ndërmor nga Kurum për të kufizuar çlirimet në atmosferë nga uzina.
- **Projekti i hekurudhës:** Projekti i hekurudhës u përfundua gjithashtu nga kompania, duke mundësuar që skrapit të transportohej direkt te uzina e shkrirjes, duke ulur në këtë mënyrë zhurmat si dhe përdorimin e kamionëve.
- **Monitorimi me pjesëmarrje:** Anëtarët e komunitetit patën mundësinë të shikonin nga afër procesin e monitorimit që zbatohet nga Kurum, duke iu bashkuar një misioni të përbashkët monitorues në dhjetor 2017.

Për më tepër, në takimin e fundit, në shkurt 2018, përfaqësuesit e kompanisë informuan anëtarët e komunitetit, se për të përmirësuar impaktin mjedisor të uzinës së çelikut, kompania po zbaton projektet e mëposhtme:

- **Gjelbërimi:** Kompania po zbaton një projekt për të rritur sipërfaqen e gjelbëruar brenda zonës së uzinës. Sipas përfaqësuesit të kompanisë që drejton projektin, në muajt e parë të vitit 2018 do të mbillen 230 pemë të llojeve të ndryshme. 250 pemë të tjera do të mbillen në gjithë zonën ku operon kompania. Buxheti për projektin e mbjelljes së pemëve do të rritet me 10-15 për qind çdo vit.
- **Përmirësimi i pastrimit të mjedisit:** Kompania ka blerë pajisje për të përmirësuar aktivitetin e pastrimit, si brenda dhe jashtë uzinës. Gjithashtu kanë miratuar buxhetin për një investim të rëndësishëm për një furrë të re me një konsumim eficient të lëndës djegëse dhe ulje të çlirimeve në atmosferë.

PËRSHTYPJE NGA PROCESI

Ndërkohë që u arritën disa rezultate pozitive përmes procesit të dialogut, kishte disa çështje për të cilat palët nuk ranë dakord, duke përfshirë dhe faktin nëse operacionet e Kurum-it shkaktojnë ndotje apo jo dhe në ç'masë.

PËRFUNDIM

Disa nga përshtypjet nga procesi përfshijnë:

- **Rritja e kapaciteteve është një element kyç për të arritur sukses:** Suksesi i një procesi të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve varet nga mundësia e palëve për të bashkëpunuar me njëra-tjetrën dhe me ndërmjetësit. Workshop-et e organizuara në fillim të procesit ndihmuan në rritjen e aftësive komunikuese dhe negociuese të palëve. Ndërkohë që procesi i dialogut ishte pezulluar, pati dhe disa ndryshime të tjera praktike: disa përfaqësues të kompanisë u larguan nga puna në Kurum, dhe disa anëtarë të komunitetit u tërhoqën nga procesi i dialogut për arsye të ndryshme. Këto ndryshime në përbërje dhe në dinamikën midis palëve patën një impakt në efektivitetin e procesit të dialogut, gjë të cilën, me raste, grupi i CAO-s e konstatoi si një pengesë për një angazhim efektiv.
- **Komunikimi me respekt reciprok:** Procesi i rritjes së kapaciteteve kontribuoi në krijimin e një platforme komunikimi duke treguar respekt midis palëve, gjë që nuk kishte ekzistuar më parë. Kjo iu krijoi palëve mundësinë për të shprehur hapur dhe me sinqeritet këndvështrimet e tyre në një mënyrë të qytetëruar.
- **Ri-organizimi i kompanisë sipas vendimit të gjykatës:** Administrimi dhe ri-organizimi i Kurum-it, si rezultat i gjendjes së tij financiare dhe vendimi pasues i gjykatës, paraqitën sfida në lidhje me pjesëmarrjen e kompanisë në procesin e dialogut, dhe kufizuan hapësirën e përfaqësuesve të kompanisë për të negociuar.
- **Ngadalësimi për shkak të pezullimit të procesit:** pezullimi i procesit për një kohë të gjatë bëri që palët të humbnin interesin dhe të zbehej angazhimi i tyre, siç është konstatuar nga CAO gjatë procesit të dialogut.

CAO e përfundoi procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për këtë rast me njohjen e marrëveshjeve që trajtuan pjesërisht shqetësimet e ngritura nga komuniteti, përveç çështjeve që kompania donte t'i adresonte vetë. Ndërkohë që nuk u arrit një marrëveshje përfundimtare nga palët, urat e komunikimit të ngritura midis kompanisë dhe anëtarëve të komunitetit si rezultat i procesit, dhe qenia e Kurum-it të hapur për të diskutuar shqetësimet me anëtarët e komunitetit, paraqesin potencial për dialog në të ardhmen për të adresuar shqetësimet reciproke.

Informacion i mëtejshme mbi rastin Kurum gjendet në faqen: www.cao-ombudsman.org.